

VENDIM
Nr. 79, datë 5.2.2025

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 702, DATË 4.11.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË
PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË
PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT ‘NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI
110/20 kV, VALIAS’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 702 datë 4.11.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikat 3 dhe 4, vlera “1 728 384 (një milion e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e katër) lekësh” zëvendësohet me “7 029 267 (shtatë milionë e njëzet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekësh”.

2. Tabela bashkëlidhur vendimit nr. 702, datë 4.11.2022, të Këshillit të Ministrave, zëvendësohet me tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Shpenzimet procedurale shtesë, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a.

III. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kamzë-Vorë, dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI
“NDËRTIMI I NËNSTACIONIT TË RI 110/20 kV, VALIAS”

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME	
	EMËR	ATËSIA	MBIEMËR	BASHKIA	NR. KADASTRAL	NR. I PASURISË	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE E PRONËS (m²)	VOL	FAQE	SIPËRFAQJA E SHPRONËSIMIT (m2)	ÇMIMI SIPAS STANDARDIT NDËRKOMBËTAR LACP (lekë/m²)	VLERA TOTALE E KOMPENSIMIT SIPAS STANDARDIT NDËRKOMBËTAR LACP (lekë/m²)	VLERA TOTALE (lekë)		
1	Devie dhe Kristina		Bushi	Tirane	2066	80/19	Are	4200	23	38	1879	1822	3,423,538.00	3,423,538.00		
2	Ramazan dhe Sajmir	Sami	Bushi	Tirane	2066	80/37	Are	1700	23	36	395	1822	719,690.00	719,690.00		
4	Vjollca	Sami	Bushi	Tirane	2066	80/39	Are	2600	1	222	1584	1822	2,886,048.00	2,886,048.00		
VLERA TOTALE											3858		7,029,276.00	7,029,276.00		